



OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

Drejtuar:

OE “NET-GROUP” sh.p.k. me NIPT L72023002P

Tiranë, Rruga “Vorpset”, pas restorant “Piazza”, ZK Nr. 8350, Nr. Pasurie 6/187/N2.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me mjete elektronike – Shërbime.

Numri i referencës së procedures: REF-95105-02-12-2024

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Mbikëqyrja e punimeve të zbatimit për objektin: “Spostimi i linjave që preken nga gjurma e aksit rrugor Thumanë – Vorë – Kashar dhe instalimi i shtyllave të demantuara në linjën Fier – Rrashbull”

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 9, datë 19.02.2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. OE “NET-GROUP” sh.p.k. me NIPT L72023002P

Vlera 3,535,000 (tre milion e pesëqind e tridhjetë e pesë mijë) Lekë pa TVSH.

2. BOE “ALFA CONSULTANTS” sh.p.k. me NIPT M31926018P

“MCE” sh.p.k. me NIPT L72203065K

“PRO GREEN” sh.p.k. me NIPT M11517040F

Vlera 3,800,000 (tre milion e tetëqind mijë) Lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE “ALFA CONSULTANTS” sh.p.k., me NIPT M31926018P & “MCE” sh.p.k., me NIPT L72203065K & “PRO GREEN” sh.p.k., me NIPT M11517040F, për arsye se:

Oferta refuzohet, sipas parashikimeve të pikës 3/c, të nenit 82, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi vlera e shprehur me fjalë (vlera me TVSH, në Shtojcën 1) ka mospërputhje me atë të shprehur me shifra.

Lista e çmimeve të shërbimeve, paraqitur nga BOE është plotësuar në mënyrë të gabuar, pasi nuk janë shënuar numrat unik të identifikimit, si dhe nuk është shënuar çmimi për njësi, sipas kërkesës së formatit të kësaj shtojce.

Nuk ka përmbushur pikën 2.2.1, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi asnjë nga anëtarët e BOE nuk ka paraqitur kopje të certifikuara të bilanceve, për të vërtetuar se në të paktën dy bilance të fundit, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, sipas parashikimeve të nenit 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.3, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, se disponon si drejtues teknik, të paktën 1(një) inxhinier ndërtimi **profil strukturë**.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE “NET-GROUP” sh.p.k., me NIPT L72023002P**, Adresa: Tiranë, Rruga “Vorpset”, pas restorant “Piazza”, ZK Nr. 8350, Nr. Pasurie 6/187/N2, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **3,535,000 (tre milion e pesëqind e tridhjetë e pesë mijë) Lekë pa TVSH**, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.